The procedure consisted in a one stage tender process for the selection of the winning bidder. Bidders submitted their i) qualification credentials, ii) technical proposal, and iii) financial offers on the bid submission deadline. Submitted bids were evaluated through a technical and financial scoring mechanism. The Financial Offer was comprised of a single bid parameter- a uniform discount on the provided price list of 160 laboratory tests. The indicative timetable for completing all requirement for the concession was July 2017 starting the procedure December 2016. The tender for the concession of laboratories took place in April 2017, and a consortium of three companies, Labopharma "Albania", "Exalab", and a company registered in the Netherlands named "AB Laboratory Solutions", was announced. Th contract was signed in aprile 2019 while the Ministry of Finance predicts that starting from 2018. Experts say that if this amount were to be invested in public laboratories, all Albanian citizens would be covered by a quality public laboratory service. The passage of medical laboratories under the administration of Public-Private Partnership was also accompanied by criticism and protests during the discussion phase. A group of doctors, chemists and lab workers protested for several days against the project that is expected to be accompanied by job cuts.

4. Conclusions and recommendations

Already known not only practically, but also theoretically the advantages or disadvantages of Public-Private Partnerships, which are being implemented in the country. It is noticeable that for this fact the topic results interested to argu to the highest level of practitioner, who clarify the researchers or implementers of PPP, but also the interested parts by answering questions on them.

As (Cepiku 2006) argued considering PPPs of this research very close of

outsourcing the international experience shows that the outsourcing of activities and services in public administrations should be evolving, similar to what happened in private companies, towards a greater orientation to the concept of public value. It is a dimension that, unlike that of cost, needs further specification in order to effectively become a guiding criterion in decision-making processes.

The relationship between government, the private sector and civil society is considered an important factor in achieving sustainable development and enhances the quality of governance. It is a well know fact, the partnership are best established through consultation, coordination, participation and mutual communication. They always remain organized on a constant debate both economic and political, hence these types of connections develop in the arena of political economy, where contracting partners are not equal.

The research came to a concrete conclusion that the civil society should be considered as a factor, because it has a real role in the implementation of the partnership, actively participates in disseminating information about them, as well as in informing about their results. The increased risk with the termination of contracts appears even for the respect of payments. Tariffs happen to be softened, especially in election years, so that private investment eroded by the government can be easily politicized by the public. To these assertions we need to add the suggestions given in the last report of the IMF mission for economic and financial developments in Albania, the extent and manner of implementation of Public-Private Partnership projects and those of the State Department report on the situation of the business climate, for foreign investments, competition, corruption and risks that may come from private investments in the form of PPP, then it becomes necessary to make a full explanation, response and theoretical, legal and practical reflection, but especially to the need for a new remedial approach in the legal framework governing this type of activity. For the debate to be properly understood and

interpreted, it is necessary to have all the right know-how about this contemporary way of financing the economy.

Also, the Ministry of Finance will not only conduct the evaluation of concessions / PPP, but will also monitor the implementation of the respective contracts, based on periodic reports submitted by the contracting authorities, after negotiating the contract with the winning operator and before signing the contract her.

Practioners supports the establishment of the Committee for the Selection of Concession / PPP Projects, as a collegial body, with the main object of activity being the selection of concession / PPP Projects, who assist with specialized expertise in drafting the feasibility study. The Committee will be assisted by the Concession Handling Agency / PPP, which will analyze the contracting authorities' requests for support with specialized expertise and propose them to the Committee for approval. The establishment of this Committee eliminates the need for specialized expertise, provided by the private sector for drafting.

Improvement of policy planning and making process. There is an obvious need for establishing clear standards, procedures and guidelines and clear responsibilities in the process of designing and drafting policies, in order to avoid arbitrary or illicit interferences, in particular by politics.

Public administration should be trained in policy assessment and evaluation; in particular in cost-benefit analysis, impact analysis, risk assessment and other advanced policy evaluation techniques. An important element that might be considered to be included in policy-making process is corruption impact assessment. Access and transparency in the policy-making process should be increased, by instituting mandatory consultations within and outside government, including hearings with interested parties, civil society, business associations, academia and media.

Legal framework and PPP practice should be reviewed in order to avoid use of PPP for creating economic rents and concentration of economic power.

Publication and public access of studies, analysis and other documents related to PPP preparation and contracting should be made public, including evaluation criteria, evaluation reports, winning bids, and contracts. Other improvements should aim at avoiding lengthy PPP contracts, in particular in the field of services; exclusion of inexperienced or financially weak companies, in particular firms leading consortiums; avoiding companies with unidentified or hidden (final) owners, and limiting or conditioning the approval of ownership change during PPP implementation.

Procurement of medication for the public health institutions should be overhauled to increase competition, improve transparency and fight corruption. Specific approaches applied in other developing countries, such as procurement of all medications by international agencies such as UNDP or WHO, can be explored. Another alternative would be procurement from independent bodies, which do not answer to the Ministry of Health or other government agencies that also formulate policies and decisions in the field of medicaments and medical devices.

References

1. Akintoye, A., & Chinyio, E. (2005). Private Finance Initiative in the Healthcare Sector: Trends and Risk Assessment. *Engineering Construction and Architectural Management*, 12(6), 601–616.
2. Allard, G.; Trabant, A. (2007): Public-Private partnership in Spain: Lessons and Opportunities. IE Business School Working Paper WP10-07.
3. Amirkhanyan A.A., Kim H.J., Lambright K.T. (2007) Putting the pieces together: A comprehensive framework for understanding the decision to contract-out and contractor performance, *International Journal of Public Administration* 30(6–7):699–725.
4. Berry, A.J. and Otley, D.T., 2004. Case-based research in accounting. In *The real life guide to accounting research* (pp.231-255) Elsevier.
5. Blanken, A., & Dewulf, G. P. M. R. (2010). PPPs in Health: Static or Dynamic? *Australian journal of public administration*, 69(1), 35–47.
6. Cepiku D., (2006), L'esternalizzazione nelle amministrazioni pubbliche. *Teorie, politiche ed esperienze a livello internazionale*, Aracne, Roma.
7. Chiucchi, M.S., Giuliani, M. and Marasca, S., 2014. The design, implementation and use of intellectual capital measurements: A case study. *Management and Control*.
8. De Vries J., Huijsman R. (2011) Supply chain management in health services: An overview. *Supply Chain Management, International Journal* 16(3):159–165.
9. Eisenhardt, K.M., 1989. Building theories from case study research. *Academy of management review*, 14(4), pp.532-550.
10. Gerring, J., 2006. *Case study research: Principles and practices*. Cambridge university press.
11. Kakabadse A., Kakabadse N. (2002) Trends in outsourcing: Contrasting USA and Europe, *European Management Journal* 189–198
12. Ménard, C. and Shirley, M.M. (2002), *Reforming Public Utilities: Lessons from Urban Water Supply in Six Developing Countries*, World Bank, Washington, DC.;
13. Mori A. (2017) The impact of public services outsourcing on work and employment conditions in different national regimes, *European Journal of Industrial Relations*. 23(4):347–364
14. Narayanan V., Schoch H.P., Harrison G.L. (2007) The interplay

- between accountability and management control patterns in public sector outsourcing. *International Journal of Business Studies* 37–65
15. OECD (2011) *Government Outsourcing*. In: *Government at a Glance 2011*, OECD Publishing, Paris, pp 168–169
 16. OECD (2017) *Government Outsourcing*. In: *Government at a Glance 2017*, OECD Publishing, Paris, pp 84-85
 17. Osborne, S. P. (2000). *Public–Private Partnerships: Theory and Practice in International Perspective*. London: Routledge.
 18. Parker, R.I., Vannest, K.J. and Davis, J.L., 2014. Non-overlap analysis for single-case research.
 19. Queiroz, C.A.V. (2007), “Public–private partnerships in highways in transition economies: recent experience and future prospects”, *Transportation Research Record: Journal of the Transportation Research Board*, No. 1996, No. 1, pp. 34-40.
 20. Rajabzadeh A., Asghar Anvary Rostamy A., Hosseini A. (2008) Designing a generic model for outsourcing process in public sector: Evidence of Iran, *Management Decision* 46(4):521–538.
 21. Ryan, B., Scapens, R.W. and Theobald, M., 2002. *Research method and methodology in finance and accounting*.
 22. Snelson, P. (2007), “Public–private partnerships in transitional countries”, *Law in Transition*, European Bank for Reconstruction and Development, London, pp. 31-37.
 23. Sullivan E.W., Ngwenyama O.K. (2005) How are public sector organizations managing IS outsourcing risks? An analysis of outsourcing guidelines from three jurisdictions, *Journal of Computer Information Systems*. 45(3):73–87.
 24. Vaillancourt Rosenau, P. (Ed.) (2000). *Public–Private Policy Partnerships*. London: Cambridge.
 25. Van de Walle S., Hammerschmid G. (2011) The impact of the new public management: Challenges for coordination and cohesion in European public sectors, *Halduskultuur – Administrative Culture*. 12(2):190–209.
 26. Yang, Y., Wang, W. and Hou, Y. (2013), “On the development of public–private partnerships in transitional economies: an explanatory framework”, *Public Administration Review*, Vol. 73 No. 2, pp. 301-310.
 27. Yin, R.K., 2004. *The case study anthology*. Sage.
Yin, R.K., 2021. *Case study methods*.

Dorian Demetja⁵

Edukata e familjes tradicionale shqiptare, ngjizur sipas modelit dhe udhëzimeve të Islamit, faktor themelor i ecurisë gjatë tranzicionit shoqëror

Abstract

History has led the Albanian many times to the brink of life, but without ever avoiding honor, as a purpose and life goal. Over time honor-erzi often rose to the level of sedra, which was also personal, family or more extended. Sedra was also educated in the family, being at the same time the yeast of its connection. Perhaps this qualitative cornerstone, expressed through the ancient language, helped him not to merge with the foreigner, being also an element of collective identity, which in the period of the National Renaissance, begins to be formed as national consciousness, but concluded in the years at least when the Kingdom of Albania ruled (1928-1939).

Recognizing the role it plays in this valuable material capital, we judge and firmly believe that the fundamental role of family education, which began its journey in early human life as a link between the biological interests of individuals, was conceived and was sanctified by the faith, legalized in the unwritten canons, becoming a family upbringing full of the fragrance and juice of life, washed with spice soaked in the life-giving source of the environment. Thus such a bond for its member was so strong that someone who did not prove as civic morality the traits acquired there, was despised by the social circle and me The article proves that this education has helped not only its member, but also society to overcome the difficulties of the time, proving to be a powerful factor.

Keywords: *family education, honor, faith, Islam, conjugal, dividend, human capital*

⁵ KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

Drejtor i Drejtorisë së Kulturës

Email: dorian.demetja@kmsb.al

Kur njeriu i lashtë ndjeu nevojën të ruante diçka për të nesërmen, nga ajo që i kishte tepruar, iu desh të gjente dhe mënyrën sesi ta kryente atë veprim me sukses. Ftoi për bashkëpunim edhe gruan me të cilën rriste fëmijët, që më pas të futeshin te ky bashkëpunim me lidhje interesi. Kështu u ngjizën “shteti i vogël”, si e quajnë hartuesit e së parës disiplinë shkencore juridike, së Drejtës Romake, familjen.

Punimet për origjinën e familjes, pronës private dhe shtetit janë në lëmi të shumta të shkencës, si: Jurisprudenca, sociologjia, antropologjia, biologjia, gjenetika, prandaj, le të qëndrojmë në krye të sqarimi i konceptit themelor të saj, duke u mbështetur te këto fusha. Fjala është huazim nga latinishtja *familia*, që e ka prejardhjen nga *famulus*, e cila ka kuptimin *rob shtëpie, shërbëtor*. Me kohë ajo mori funksionet e tjera veç atij të robit të shtëpisë, që djepi gjuhësor hyri në fushën shoqërore që e pranoi si njësi më e vogël e përbërë nga dy apo më shumë persona në lidhje martesore, gjaku ose birësimi. Që grupi të përforcohet, duhet të jetojë në mjedis të njëjtë për një kohë jo të pakët, të ndërtojë marrëdhënie kulturore dhe ekonomike të përbashkëta, si dhe të mbrojnë apo përkujdesen për njëri-tjetrin pa interes ose shpërblim, siguri që i jepet atij apo asaj që i duhet më fort.

Me evoluimin e shoqërisë, familja u vu në mbrojtje të saj dhe shtetit, siç shprehet te *Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e Njeriut*, neni 16(3): “Familja është njësi bazë grupore e shoqërisë dhe i jepet mbrojtje nga shoqëria dhe shteti.” Përkufizimet mbi të nuk kanë mundur të ndalen. Rreth gjysmë shekulli më parë antropologu dhe pedagogu amerikan i universitetit të Pitsburgut, Xhorxh Murdok (George P. Murdock) gjykoi se familja amerikane nuk ishte gjë tjetër veçse:

“Një grup social që karakterizohet nga mendimi praktik, bashkëpunimi ekonomik dhe riprodhimi. Ajo përfshin të rritur të çfarëdolloj seksi (femër & mashkull, mashkull & mashkull, femër & femër etj.) ku të dy duhet të mbajnë një lidhje të miratuar nga shoqëria dhe një ose më shumë fëmijë, të vetin apo të birësuar, nga të rriturit që bashkëjetojnë seksualisht.”

Murdok duke qenë edhe etnolog, te artikulli që ai është bashkautor: “Matja e kompleksitetit kulturor”, ka studiuar deri individin në shoqëritë pa shtet, parashtrori idenë e guximshme se në epokën e shoqërisë së konsumit, ka rënë tisi i shenjtë dhe lidhjet e individëve në familje të tilla i dikton para së gjithash interesi, veprimtaria praktike dhe nevoja, shpirti dhe jo zemra. (Murdoch, G. P. & Provost, C., 1973/Oct.: 379)

Me interes janë edhe përkufizimet juridike apo enciklopedike. Në to sqarohet se nga cilët pjesëtarë formohet familja tradicionale dhe nga cilët përbëhet ajo sot. Nga to veçon përkufizimi socialo-juridik që e pranon familjen, e cila përmban një grup të njerëzve shtëpiakë, bashkuar nga lindja, martesë ose marrëdhënie të përiferëta, përfshi bashkëjetesën, birësimin, mbiemrin dhe pronësinë (në disa raste), siç është cilësuar qysh herët te *E drejta romake*.



Francisco de Goya *Portret i një familjeje*

Kësisoj familja u ngjiz si njësi parake njerëzore, në të cilën individ i komunikon me kushtet e jetës, që përcaktojnë kornizën e tij, ku ai rritet duke e ndier veten pjesëtar dhe ku formon personalitetin njerëzor si individ, në procesin e ndërveprimit shoqëror.

Edhe sa u përket llojeve, ekzistojnë disa të tilla. Në to shihen vetëm lidhjet e gjakut, apo këto lidhje duhen kuptuar metaforikisht. Sociologjia dhe antropologjia gjejnë mirëkuptim kur e konsiderojnë familjen se e ka funksion themelor riprodhimin biologjik, shoqëror ose të dyja bashkë. Sa i përket funksionit të familjes në rritjen dhe edukimin e fëmijëve, gjithë disiplinat shkencore njëzëri pranojnë se është drejtues, sepse ndikon për t'i edukuar, kulturuar dhe drejtuar në jetë. Nuk ka mbetur jashtë vëmendjes as e ardhmja e prindërve, që familja u shërben si institucion i pjellorisë, me synim lënien e trashëgimtarëve, edukimin dhe shoqërimin e tyre.

Ky institucion nuk ka ngelur statik, evoluon dhe kohët e fundit mësohet se ka familje të reja që nuk planifikojnë të lindin fëmijë, dukuri e cila e rrëzon elementin e pjellorisë si ngjizësin kryesor të familjes.

Më e lehtë është përcaktimi i familjes tradicionale, që sipas antropologëve hyn në një prej tri llojeve, gjithnjë duke shfaqur marrëdhëniet prindër-fëmijë, midis bashkëshortëve apo të dyja llojet e marrëdhënieve së bashku:

1. matrifokale (amësore)
2. konsaguine (gjaklidhëse)
3. konjugale (bashkëshortore)

Jemi të mendimit se familja e lashtë shqiptare hyn në llojin konsaguin, e lidhur me rastin kur meshkujt zotërojnë pronë dhe veç çiftit hyjnë në të edhe fëmijët, si dhe pjesëtarë të tjerë të familjes së burrit. Kur bashkë me ta jetonin edhe xhaxhai apo xhaxhallarët e burrit së bashku me familjet e veta, ishte formuar asisoj familja patriarkale, që pothuajse është zhdukur kohët e fundit në mjediset shqiptare.

Familja patriarkale në kullën e veçuar, që zakonisht ngrihej jo pak larg nga kulla fqinje, organizohej dhe qeverisej si një 'shtet i vogël'. Aty vendimmarrjen kryesore, atë në raport me fqinjin e deri me farefisën e zotëronte më i moshuari i konakut, kurse organizimin për punët e zakonshme të familjes e kishte përsipër bashkëshortja e tij.

Tiparet e saj konsaguine janë të përcaktuara saktë në kanunet (kodet) e lashta shqiptare, ato vunë dhe përforcuan themelet mbi të cilën ngrihej familja, duke u plotësuar me elemente të besimeve fetare të pranuar vullnetarisht prej tyre, besime që erdhën edhe si kulturë duke u reflektuar edhe në etikën e moralin e celulës bërthamë të jetës njerëzore. Më tepër se nga lidhjet e gjakut, pjesëtarët e

familjes i bekuan dhe i fisnikëruan marrëdhëniet brenda dhe midis tyre, duke i kthyer në kode të zyrtarizuara familjare. Edhe pse jo rrallë herë në kufijtë e mbijetesës, një organizim i tillë e shpëtoi atë nga përthithja e pushtimeve të huaja, disa prej të cilave kishin si synim zhdukjen e popullsisë shqiptare dhe popullimin e trojeve me kolonët e huaj. Megjithatë shqiptarët popullojnë tashmë hapësira gjeografike të mpakura, krahasuar me epokën ilire, kur paraardhësit e tyre zotëronin troje disa herë më të mëdha, madje kohët e fundit ka studiues boshnjakë që në konferenca shkencore ndërkombëtare apo në botime serioze, pranojnë origjinën e tyre ilire.

Tashmë familja shqiptare është në tranzicion, duke u bashkëshoqëruar nga të njëjtat tipare që bashkëshoqërojnë reformimin ekonomik, politik, juridik, kulturor e social të shoqërisë shqiptare bashkëkohore. Shoqëria dikur e mbyllur, përfshi periudhën kur Shqipëria ishte nën sistemin totalitar, po transformohet në një shoqëri të hapur, me plot tipare të shoqërisë së konsumit, ku autoriteti i prindit nuk është më i padiskutueshëm dhe ndihet se është prekur shenjtërimi i saj. Pjesëtari i këtij modeli të ri familjar, ndihet më tepër si individ i këtij institucioni social dhe përpiket të marrë më shumë përgjegjësi vetjake, por gjithnjë e më pak të jetë shërbëtor i njerëzve të gjakut.

Morali i ri familjar nuk i pranon më martesat me mblesëri, por edhe vetëm ato që ngrihen mbi bazën e njohjes dhe pëlqimit vetjak, sepse i ka çelur hapësirë bashkëjetesës para martesës apo si një formë bashkëkohore e martesës. Është rritur mosha mesatare e pjesëtarëve të çiftit, por është ulur numri i fëmijëve që ata sjellin në jetë. Statistikat zyrtare njoftojnë për një sasi jo të pakët beqarësh, që në moshë madhore as e kanë menduar fillimin e jetës në çift.

Dihet shumë mirë, pranohet dhe zbatohet prej kur nuk mbahet mend, që zhvillimi i njerëzimit është projektuar dhe ndodh vetëm prej dhe mbi strukturën familjare, sepse ky është më shumë se një ligj natyror, më shumë se një ligj shoqëror, ai është një nga ligjet hyjnore, i cili erdhi dhe u zbatua si porosi e Zotit. Prandaj në këtë artikull do të bëhet fjalë për modelin e ndërtimit

dhe funksionimit të familjes dhe jo për nocionin apo konceptin e saj.

Thuajse të gjithë filozofët, antropologët dhe sociologët, pavarësisht rrymave të mendimit filozofik ku mbështeten, janë të njësuar në domosdoshmërinë e njësisë familjare. Qëndrimi është miratuar me mbështetje ndërkombëtare si në Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe në Kodet e Familjes, që aplikohen në sistemet juridike të të gjitha shteteve në botë. Kështu debati ideor zhvillohet në prizmin e ndërtimit të saj, të funksionimit dhe efektshmërisë së llojeve dhe modeleve alternative, që ofrojnë zhvillimet shoqërore në kohë të ndryshme.

Familja është një institucion me hir të shenjtë, origjina e së cilës të çon kryekreje në krijimin e çiftit të parë njerëzor, që shumoi shoqërinë njerëzore, njeriun si të caktuarin dhe të vlerësuarin prej Tij. Lidhur me këtë përcaktim në *Kuran* thuhet:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra.”⁶

Në një vend tjetër thuhet:

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”⁷

⁶ Nisa, 4:1.

⁷ Rum, 30:21.

Ashtu siç Krijuesi caktoi Ademin dhe Nuhun si zanafillës të individualitetit njerëzor dhe besimit të kulluar, po ashtu Allahu i Gjithëditur përzgjedhi mes njerëzisë familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit, si përfaqësueset më të mira të modelit të familjes.⁸ Ato janë familje që i kanë ndërtuar marrëdhëniet e pjesëtarëve të vet tërësisht sipas mësimëve kuranore apo porosive profetike, ndërkohë që shërbejnë me përkushtim për fenë e Zotit dhe që janë përkujdesur e kanë lënë pasardhës të kapur fort pas besimit të pastër. Ismaili, Is'haku, Jakubi, Jusufi dhe Isai, qenë disa nga Lajmëtarët e dalluar, pasardhës të këtyre dy familjeve të nderuara. Përmes ajeteve kuranore, që përshkruajnë copëza domethënëse nga jeta e këtyre dy familjeve, Allahu na orienton në rrugën më të mirë të modelimit hap pas hapi të një familje të shëndetshme.

Sipas Islamit familja qëndron mbi bazën e lidhjeve të forta të ortakëve bashkëshortorë për të rritur dhe edukuar fëmijë me moral të pastër e të orientuar drejt në jetë. Orientimi themelor, sot, në sajë të lirisë dhe të drejtave të njeriut, po ndryshon këto lloj marrëdhëniesh dhe po prihet gjithmonë drejt jetës së lirë private, duke u shkëputur nga edukata familjare dhe pastërtia e saj morale. Në sajë të kësaj lirie edhe bashkëshortët, burrë e grua, po priren për të bërë jetë të pavarur, duke u dhënë pas pasioneve dhe kënaqësive të ditës, gjë që ka çuar e po çon gjithnjë e më shumë drejt zvetënimit të tipareve të dukshme të familja tradicionale.

Jeta e njeriut, si individ apo edhe në familje e shoqëri, duke anuar gjithmonë nga ana materiale dhe sigurimi i tyre në rrugë nga më të ndryshmet, të drejta e të padrejta, ka lënë pas dore vlerat morale e deri të shenjta. Civilizimi modern, ku duam të jetojmë, ka sjellë me vete bashkë me mundësitë që ofron epoka digjitale, edhe mjaft probleme sociale, që nga mbrojtja e fëmijëve, e jetimëve, tradhtia bashkëshortore dhe deri te shpërbërja e lidhjeve brenda individëve të familjes, dhuna ndaj femrës, trafikimi, prostitucioni, droga, etj., e deri te

⁸ Al'Imran, 3:33.

mbrojtja e kujdesi për të moshuarit. Këto dukuri që vërehen sot në Shqipërinë tonë, e kanë zgjidhjen te njohja, pranimi dhe zbatimi i Islamit si kulturë dhe edukatë. Ato të dyja, kultura dhe edukata, mund të bëhen faktor i rëndësishëm jo vetëm për qartësimin, por edhe për zgjidhjen e parandalimin e shfaqjes së këtyre problemeve familjare apo shoqërore, sepse ofrojnë besnikëri në marrëdhëniet ndër-njerëzore, ndershmëri, mirësjellje dhe sinqeritet, jo vetëm në familje ndërmjet pjesëtarëve të saj, por edhe midis anëtarëve të shoqërisë, pa dallim gjinor, duke respektuar të drejtat e secilës gjini. Bie në sy që morali që kultivohet sot në shoqërinë tonë është synon të shkëputet nga cilësitë dhe tiparet fetare, duke nisur të humbë karakteristikat e vlerave shpirtërore si humanizmi, dashuria, vëllazëria, bamirësia, mëshira, etj.

Sociologu Will Durant, i cili së bashku me një tjetër Durant qysh në vitet '60 kishte cituar sentencën e Heraklitit: “Polemos pater panton”, kishte sqaruar se paqja duke qenë një ekuilibër i paqëndrueshëm, mund të ruhet vetëm me epërsi të pranuar ose duke zotëruar fuqi të barabartë. (Durant, W. & Durant, A, 1969: 56-57) Në veprën e vet *Mrekullitë e filozofisë* ai parashikoi se mbulesa e barazisë së femrës me mashkullin, do të përbuzte pastërtinë dhe turpin, si stoli të bukurisë njerëzore mbi të cilat ngrihet e mbrohet familja.

“Jeta në qytetet e civilizuar nuk lejon njeriun as të mendojë për martesën, ndërkohë që pasionet seksuale rriten, ndërsa konditat e bëjnë kënaqësinë tepër të afërt... Kështu pastërtia që dikur është konsideruar virtyt, është bërë objekt i përbuzjeve dhe poshtërimeve. Në një atmosferë të tillë tretet edhe turpi, i cili dikur i ka stolitur të gjitha bukuritë e njeriut, ndërsa njerëzit krenohen me mëkatet e tyre, nën mbulesën e barazisë me mashkullin, femrat hyjnë në lidhje të pakufishme jashtëmartesore, ndërsa marrëdhëniet e ndaluara paramartesore bëhen diçka e zakonshme.”

Në vetëm disa dekada, parashikimi i Durant na duket se po ulet këmbë mbi këmbë edhe në shoqërinë shqiptare, e cila historikisht ka qenë mes Perëndimit dhe Lindjes, (Çabej, E., 2006), duket se po kapërcen edhe pengesat e kështjellës familjare. Muret e kësaj kështjelle vijojnë të qëndrojnë atje ku edukata dhe kultura evoluon, po me hapa të matur dhe pa e prekur identitetin kombëtar. Na duhet të integrojmë në BE, por pa harruar të shpiem atje edhe identitetin tonë fetar, kulturor dhe edukatën tonë familjare, pjesë integrale e identitetit kombëtar.

Besimi në Zotin është themeli i jetës së njeriut dhe pikërisht ky besim do të bëhet faktor shumë i rëndësishëm për t'i larguar njerëzit nga jeta e shthurur, do të përmirësojë moralin shoqëror dhe do ta ruajë atë të pastër. Sado që feja me ligj është e ndarë nga shteti, ajo është integrale në shoqëri, luan rolin e saj në jetën e përditshme, e shoqëron njeriun në lindje e deri në vdekje, në gëzime e hidhërim. Kjo nuk duhet të përdoret thjesht si mbulesë e jashtme vetëm për ceremonitë e ndryshme, por ajo duhet të bëhet pjesë aktive në veprimtaritë e jetës së përditshme të njeriut.

Feja islame shpesh vatërzohet te rëndësia e familjes dhe e konsideron atë si kala mbrojtëse përballë jetës pa parime morale, sepse është vendi ku natyra njerëzore mund ta shprehë veten në mënyrën më të mirë, ku mund t'i realizojë dhe kthejë në realitet vlerat e larta, si: dashuria, respekti, dhembshuria, sakrifica, besnikëria dhe bindja. Sistemi i familjes islame i vendos të drejtat e burrit, gruas, fëmijëve dhe të të afërmeve në një ekuilibër të përsosur, marrëdhënie që nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjeguara deri në detajet më të imëta. Rreth një e treta e normave juridike që përfshihen në *Kuran* i referohen familjes dhe përcaktojnë rregullat e funksionimit të saj. Struktura familjare në fenë islame është e ndërtuar mbi baza të shëndosha, me qëllim të suksesit dhe vazhdimësisë së saj. Le t'i njohim dhe analizojmë ato me radhë:

E para. Besimi. Me anën e besimit dhe legjislacionit islam, secili nga bashkëshortët i di të drejtat dhe detyrimet e veta dhe ka para vetes një program të qartë për zgjidhjen e problemeve që krijohen prej tyre. Burri dhe gruaja plotësojnë njëri-tjetrin; respektimi i përbashkët i vlerave të martesës dhe besnikëria në mes bashkëshortëve janë elementet kryesore, që e fuqizojnë paqen dhe harmoninë në jetën bashkëshortore. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë:

*“Vërtet besimin më të plotë e ka ai besimtar që ka moralin më të lartë dhe sillet mirë me familjen e tij”.*⁹

E dyta. Martesa. Me pëlqim të dyanshëm në çift, sepse vetëm një martesë e tillë do të jetë e suksesshme. Islami e ndaloi imoralitetin dhe ndërmori masa të ashpra për ndalimin e tij, sepse imoraliteti është sulm i hapur ndaj sistemit të familjes dhe shenjtërisë së saj. Kështu, Islami hapi dyert për formimin e familjeve duke iu përgjigjur natyrës dhe tipareve të njeriut, me të cilat i pajisi Krijuesi njerëzit. *Kurani* shpjegon se martesa ishte traditë e profetëve, siç shihet në ajetin vijues:

*“Vërtetë, edhe para teje Ne kemi sjellë të dërguar, të cilëve u kemi dhënë gra dhe pasardhës.”*¹⁰

E treta. Përgjegjësia e përbashkët. Martesa detyron përgjegjësi të caktuara, të cilat i përkufizon legjislacioni Islam. Këtu përfshihen të drejtat e burrit, të drejtat e gruas dhe përgjegjësitë që kanë për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Hulumtimet e shumta shkencore vërtetojnë se shumica e atyre që kanë devijuar dhe janë zhytur në rrugën e kriminalitetit, janë ata që nuk kanë pasur rastin të shijojnë ngrohtësinë familjare, si dhe nuk kanë pasur rast të edukohen me vlerat dhe ndjenjat e jetës së familjes së shëndoshë. Feja islame

⁹ Tirmidhi.

¹⁰ Ra'd, 13: 38.

ka për qëllim të krijojë familje të shëndosha për shoqëritë, përfshi shoqërinë tonë. Këto familje të shëndosha nuk mund të shkatërrohen lehtë dhe nuk bien lehtë nën ndikimin e streseve shoqërore dhe morale. Familjet e ngritura mbi vlera të larta si besimi, besnikëria, dashuria e sinqertë, bindja e vetëdijshme dhe morali i bukur, janë garancia më e madhe e shoqërisë.

Sigurisht, një fole familjare pa synim, e ngritur mbi dëshira fizike, pasione të çastit, qejfe, zili apo smira, jo vetëm që nuk do të premtojë të ardhme, por do të mbetet në trup të popullit si një element potencial negativ. Po qe se femra dhe mashkulli nuk kanë lidhje me Zotin, apo nuk konsultohen me kulturën dhe edukatën që vjen prej tij, nuk ka mundësi që fëmijët që do të vijnë prej tyre të jenë të vetëdijshëm, të ndjeshëm, të ekuilibruar e të bartin ndjenjën e përgjegjësisë.

Allahu i Lartësuar, nëpërmjet *Kuranit*, na përkujton lutjet e Zekerijes dhe Ibrahimit, për të na përkujtuar se prindërit, që në krye të herës dhe vazhdimisht, duhet t'i luten me sinqeritet Zotit për fëmijët. Lutjet duhet të jenë si për zhvillimin shpirtëror familjar, ashtu edhe për përparimin material e civilizues. Lutjen dhe përgjërimin me ndjenjat më të sinqerta të profetit Zekerija drejtuar Allahut, *Kurani* e përshkruan kështu:

“Aty Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: Zoti im, dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Pa dyshim, Ti je dëgjues i lutjes!”¹¹

Po ta vëmë re me kujdes, profeti Zekerija nuk kërkoi vetëm një pasardhës çfarëdo, por “të mirë”! Ai donte të thoshte: Më fal një pasardhës “të mirë” që ta bëjë Zotin të kënaqur, të atin të lumtur, por njëherazi të bëhet njeri i dobishëm për shoqërinë! Prandaj edhe Hz. Ibrahim me të birin, Hz. Ismailin, kur po ndërtonin Qaben, i luteshin Zotit kështu:

¹¹ Al’Imran, 3:38.

“Zoti ynë! Na bëj të dyve (babë e bir) të bindur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të bindur ndaj Teje! Na trego ritet e adhurimit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimeve, Mëshirëploti!”¹²

Të njëjtën esencë besimi përmbante edhe lutja e gruas së nderuar të Imranit për foshnjën ende të palindur (Merjemen):

“Zoti im! Këtë që është në barkun tim, vendosa ta kushtoj vetëm për shërbimin Tënd. Pra, pranoje këtë prej meje!”¹³

Si këta shembuj, por edhe në tekste të tjera të shenjta mund të vërehet se kërkohen breza të pastër si fryte të krijimit të familjes. Pra, në të gjitha këto lutje është tërhequr vëmendja mbi breza të pastër, të pafajshëm, të pamëkatë, jo vetëm besimtarë të bindur, por edhe me kulturë dhe edukatë fetare. Roli i familjes mbetet i paplotësuar, nëse nuk realizon rritjen e fëmijëve të vet, me edukatë islame, si dhe me arsim të përgjithshëm dhe profesional. Prindërit duhet të mbështesin rritjen dhe formimin e personalitetit të shëndoshë të fëmijës, si nga ana fizike ashtu edhe nga ana mendore e shpirtërore, për ta bërë atë të aftë si besimtar, qytetar, por dhe për mbrojtjen e vendit të tij. Zoti (xh.sh.) në *Kuran* urdhëron e thotë:

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri...”¹⁴

Ky ajet i *Kuranit* përmbledh një dispozitë me rëndësi edukative dhe me normat morale të fesë islame për fëmijën, që duhet edukuar që në moshë të njomë. Në edukimin dhe arsimimin e fëmijës, familja mbetet vatra e parë, shkolla e parë

¹² Bekara, 2:128.

¹³ Al’Imran, 3:35.

¹⁴ Tahrim, 66:6.

dhe djepi ku përkundet e ardhmja e gjithsecilit. Pa diskutim, kohën që veçojnë prindërit për mësimin dhe edukimin e fëmijëve, duhet ta parapëlqejnë ndaj kohës që veçojnë për disa detyra personale, individuale. Në rritjen e fëmijëve, mësimi mbi Zotin, shtresimi në zemra i idesë së besimit mbi Të sipas moshës dhe nivelit kulturor të fëmijëve, kanë përparësi jo vetëm në begatimin moralo-shpirtëror të prindërve, por edhe në shumë detyra vetjake të tyre.

Ndikim më të madh ka shembulli dhe përkushtimi i prindërve në marrëdhënie me fëmijët. Sami Frashëri porosiste që të mos jepeshin këshilla, por të lejoheshin fëmijët të mësonin nga veprimet e prindërve. Çdo nënë e baba mysliman, në mënyrë mjaft të natyrshme, mendojnë t'i edukojnë fëmijët në formën e përkryer të asaj shoqërie ideale, të cilën përpiqemi ta përfytyrojmë dhe përvijojmë sipas *Kuranit*. Mirëpo, nëse këto ndjenja të tyre nuk reflektohen në jetën praktike dhe nuk thellohen me adhurime të tilla si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, ose, në edukimin e mirë të tipareve të caktuara morale e fetare, si ndershmëria, drejtësia, dashuria, vëllazëria etj., rezultati do të jetë i dobët ose i paqenë. Pa le kur prindërit bëjnë të kundërtën e atyre që thonë apo këshillojnë!

Në një rrëfim që i atribuohet imam Adhamit, Ebu Hanife, prej nga vijnë disa këshilla, thuhet se atë kohë ishte një djalë që i bënte dëm mjalti dhe, me gjithë këshillat djali vazhdonte të hante. E marrin djalin për dore, e çojnë te imami dhe i thonë: “Këtij djali i bën dëm mjalti, por ai, megjithëse e këshillojmë, vazhdon të hajë!” Imam Adhami u thotë: “Merreni djalin e shkoni dhe sillmani pas 40 ditësh!” E çojnë përsëri djalin te imami, i cili e merr dhe e këshillon të mos hajë mjaltë. Djali ngrihet nga vendi, ia puth dorën të atit dhe i thotë: “Baba, nuk kam për të ngrënë më mjaltë!” Të pranishmit e pyesin imamin: “O imam, pse nuk e këshillove djalin kur e prëmë për herë të parë, por na bërë të prisnim dyzet ditë?!” Imam Adhami i sqaroi se ai vetë kishte ngrënë, por prej 40 ditëve ai nuk hëngri më dhe në një gjendje të tillë e këshilloi të voglin.

Në edukimin e fëmijëve nuk ka ndikim vetëm familja, por edhe faktorë të tjerë të mjedisit apo djepit social, përfshi këtu mediat, që mund të sjellin shumë pasoja negative nëse nuk kontrollohen mirë emisionet dhe mesazhet e tyre. Po kështu në mjediset shoqërore, në rrugë e kudo, ndeshemi me fenomene të ndryshme, si sharje, fyerje, fjalor banal, mungesë respekti e sjellje të tjera të papëlqyeshme. Për të përballuar këtë ndikim negativ, familja luan rolin nëpërmjet ndërhyrjeve aktive për të bërë sqarimet e nevojshme mbi dallimin e së mirës nga e keqja dhe për të mos i lënë të bëhen viktimë e këtyre ndikimeve të këqija.

Mbetet detyrë e prindërve që t'u thellojnë besimin fëmijëve të tyre dhe t'i ruajnë ata nga fjalori i pahijshëm dhe shoqëria e keqe, që i tërheq drejt veseve negative, si gënjeshtria, vjedhja, dëmtimi i pronës së tjetrit, etj. Edukata islame e preokupon fëmijën të asimilojë çdo veprim në shërbim të besimit islam. Formimit të koncepteve morale elementare, si dhe të adhurimit të fesë islame, duhet t'u jepen rëndësi qysh në moshën kur fëmija përgatitet për të shkuar në shkollën fillore, që më vonë ai të bëhet i vetëdijshëm për veprimet që kryen.

Pavarësisht se ka shumë punë për të bërë, është një e vërtetë që në shoqërinë e sotme, nëpërmjet të moshuarve, por edhe nëpërmjet studimeve, ka depërtuar në familjet e tyre besimi islam, duke luajtur një rol të madh për edukimin e brezit të ri. Ky depërtim i ndjenjave dhe mësimave fetare ka zënë vend edhe te shumë të rinj, duke ndryshuar mentalitetin e tyre në drejtim të realitetit islam në vendin tonë. Me kohë edukata familjare u shpërnda gjithkund në djepin kulturor të mjedisit, ku gjallonin disa besime fetare, djep i cili e legalizoi atë në kanunet e pashkruara, mbi të cilat organizohej jeta shoqërore sipas fiseve, bajraqeve dhe krahinave. Në *Kanunin* e Lekë Dukagjinit thuhet se cilat ishin detyrat, por edhe të drejtat e themeluesve të çiftit, por pa harruar që si fjalë kyçe të qëndrojnë fjala *nder*:

Burri a'në detyrë:

- a) Me u perkujdesë per veshë e mathë e per gjithshka të lypet per me mbajtë jeten;
- b) me ruejtë nderen e grues e mos me e lanë me u ankue per kurrnji nevojë.

Grueja a'në detyrë:

- a) Me i a ruejtë nderen burrit;
- b) me i rroque pa zhibla;
- c) me i ndejë nen sundim;
- d) m'u pergjegjë detyrve të kunorës;
- e) me rritë e me mkambë fmin me nderë;
- f) me i ndejë gadi me të veshmen e të mathmen (kah e qepmja);
- g) mos me iu perzie në fejes të të bijve e të të bijave.

Historia e ka shpënë jo pak herë shqiptarin në zgrip të jetës, por pa shmangur kurrë nderin, si qëllim dhe pikësynim jetësor. Me kalimin e kohës nderi u ngrit shpesh te niveli i sedrës, që gjithashtu ishte vetjak, i familjes apo më i shtrirë. Edhe ajo edukohej në familje, duke qenë njëkohësisht tharm i lidhjes së saj. Ndoshta kjo ngjizje cilësore, nyjëtuar me anë të gjuhës së lashtë, e ndihmoi të mos shkrihej me të huajin, duke qenë element i identitetit kolektiv, i cili në periudhën e Rilindjes Kombëtare, nis të formatohet si vetëdije kombëtare, e përmbyllur në vitet e pakta kur zotëronte Mbretëria Shqiptare (1928-1939).



Pandemia COVID-19 do të hyjë, gjithashtu, në histori edhe për nga dëmet që i ka krijuar familjes dhe kapitalit njerëzor të saj, të cilat do të kishin sjellë pasojë edhe më të rënda, në qoftë se nuk do t'u kishte dalë para zhuallit i shenjtë, që merr në mbrojtje celulën themelore të jetës njerëzore. Zhvillimet demografike të vendit në kohët e fundit, që kishin nisur tronditjen edhe para pandemisë, do të përkeqësohen më tej prej uljes së lindjeve dhe emigracionit të lartë, ndërsa cilësia e jetës do të jetë nën tryshninë e rritjes së sëmundshmërisë, mangësive në arsim, riaftësimin të vështirë të ekonomisë së vendit dhe uljes së remitançave, që mbajnë gjallë familje të tëra, apo u vijnë në ndihmë më nevojtarëve të saj.

Është me vlerë të përmendet përballë pritshmërisë jo optimiste se për dy dekadat në vijim do të përjetohet dividendi demografik, ndërkohë që popullsia në moshë pune e Shqipërisë do të jetë më e lartë se grupet e tjera që nuk punojnë (popullsia deri në 15 vjeç dhe ajo mbi 65 vjeç). Veçse duhet theksuar se kjo periudhë e artë demografike që krijon dritaren e mundësive, e cila nuk përsëritet brenda shekullit, vjen si pasojë e lindshmërisë së lartë të para 30-vjetëve, por edhe ekonomia mbështetet, sepse, ndërsa rënia e lindjeve të

kohëve të fundit rriti ofertën e popullsisë aktive për punë, nga ana tjetër uli shpenzimet që kërkon prindërimi.

COVID-19 po rrit sëmundshmërinë e popullatës, sepse ndërsa energjitë jetësore të sistemit shëndetësor drejtohen për përballimin e pandemisë, sëmundjet e tjera nuk kanë reshtur, madje provohet se pandemia po bëhet shkak për rritjen e tyre, ndërkohë që sëmundjet parësore janë përkeqësuar më tej gjatë kohës dhe duke mos u trajtuar kur duhet. Specialistë të shëndetësisë argumentojnë se pandemia ka thithur shumë energji të strukturave spitalore, ndërkohë që rrezikon të tejmbushet me fëmijë deri pavijoni i pediatriisë në QSUT.

Popullsia e Shqipërisë, sipas ekspertëve të fushës, e përfshirë në procesin e plakjes dhe rënies së lindshmërisë, përjetonte një barrë sëmundjesh në rritje edhe para pandemisë, por koronavirusi pritet t'i përkeqësojë prirjet, sidomos në periudhën afatmesme, ndërsa burimet financiare qeveritare do të jenë më të kufizuara për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje për shërbime shëndetësore. Për këtë arsye burimet ekonomike të familjeve në periudhën afatmesme do të kanalizohen për trajtimin e shqetësimeve shëndetësore.

Sipas të dhënave statistikore, mendohet se pandemia do të shuajë shtesën e popullsisë së vendit, sepse në vitin 2020 shtesa natyrore e popullsisë iu qas nivelit zero, me vetëm 470 lindje më shumë se vdekjet. Në rreth një shekull, duke filluar prej vitit 1923, kur filloi zyrtarisht regjistrimi i popullsisë në Shqipëri, lindjet kanë qenë shumë më të larta se vdekjet, ndërkohë që sipas INSTAT shtesa natyrore në vitin 2020 është thujse zero, krahasuar me më shumë se 6 mijë persona në vitin 2019, rreth 15 mijë në vitin 2014, mbi 34 mijë në vitin 2000 dhe mbi 63 mijë në vitin 1990.

Në anë tjetër, vërtet që emigracioni ka tkurrur popullsinë banuese në vend, por sërish ky kontingjent mund të konsiderohet rezervë, pasi nuk përjashtohet mundësia e rikthimit të tyre. E shkuara jonë por dhe përvoja e huaj provojnë se po të mos ishte harruar kujdesi brenda familjes dhe mbështetja

jashtë saj, ky numër do të ishte shumë më i vogël. Për ilustrim po japim proverbin e mbledhur në Shkodër: “Dole shpijet, dole erzit.”, ku fjala *erz* ka kuptimin nder, dinjitet, namus. (Dizdari, N. Tahir, 2005: 255)

Të dhënat më të hershme, të pa grupuara vit pas viti, tregojnë se Shqipëria tani ka shtesën natyrore të popullsisë në nivelin më të ulët që nga viti 1923, pasi shtesa e popullsisë gjatë viteve 1923-1945, ishte mesatarisht mbi 18 mijë persona në vit, shtesë që u rrit pas LIIB. Ndryshimet politike të ndodhura pas vitit 1990 ndryshuan kahun e shtesës natyrore të popullsisë, e cila ka ardhur në rënie të vazhdueshme, duke reflektuar rritjen e moshës mesatare të popullsisë, nivelin e lartë të emigracionit, zvogëlimin e familjeve brenda vetes dhe rënien e fertilitetit (aktualisht rreth 1.35 lindje për grua, ndër më të ulëtat në Evropë).

COVID-19 e përkeqësoi situatën, pasi ndikoi në një rritje të pazakontë të vdekjeve, ndërkohë që studiuesit konstatojnë se Shqipëria në fazën e tretë të tranzicionit demografik (periudha kohore nga viti 1970-2015), vijon t'i ulë periodikisht lindjet me vetëm 1% në vit. Ndodhi kështu pas fazës së parë të periudhës nga viti 1920-1950, kur ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë ka qenë rreth 1.7%, pas fazës së dytë në periudhën nga viti 1950-1970, kur ky ritëm vjetor i rritjes së popullsisë ka qenë 2.96%. Duke i shtuar kësaj dukurie edhe emigrimin, sociologët rreken të bindin me shifra se pse ka ardhur në ulje numri i popullsisë në Shqipëri nga viti në vit, duke mos pranuar si faktor familjen dhe problemet e shfaqura brenda saj.

Në vitin 2020 lindën 28.075 foshnja, duke shënuar rënie me 1.7%, krahasuar me një vit më parë, duke provuar se pandemia e nxiti më tej rënien e lindjeve. Studime të botuara së fundmi në revista argumentojnë se COVID-19 e mbështet këtë rënie. Para pandemisë, Shqipëria po përjetonte rënie të shpejtë të lindjeve, por si pasojë e situatës, zhvillimet demografike janë duke u zhvilluar sipas skenarëve pesimistë të projeksioneve statistikore të popullsisë. Sipas

rishikimit të fundit lidhur me periudhën kohore 2019-2031, indeksi i fertilitetit për një grua në vitin 2019 ishte 1.36, për shkaqet e argumentuara më sipër.

Sociologët nuk ndalen me statistika në nivele të ndryshme për të argumentuar rënien e lindjeve, shtimin e vdekjeve, largimin e popullsisë në emigracion, por pa argumentuar askund pse dhe sesi këto dukuri janë reflektuar në marrëdhëniet familjare. Sipas tyre Indeksi Sintetik i Fekondimit do të arrijë nivelin 1.2 pas vetëm dhjetë vjetësh, ndërkohë që pritmëritë reale po tregojnë (gjithnjë sipas tyre) se ky nivel do të arrihet para këtij afati.

Në këto kushte vdekshmëria do të rritet në vitet që vijnë. Me 27.605 humbje jete, viti 2020 regjistroi nivelin më të lartë historik, duke pasur rritje prej 26.4% krahasuar me mesataren e viteve 2016-2019. Prirja përkeqësuese nisur disa dekada më herët, aq sa në vitin 1990, kur Shqipëria numëronte 3.2 milionë banorë, vdekjet ishin rreth 18 mijë banorë, u ngrit për vitin 2020 në 21.600 banorë, kur vendi numëronte një popullsi prej rreth 2.7 milionë banorë. Duhet theksuar se humbjet e jetëve nuk kanë ardhur vetëm në mënyrë të natyrshme, por edhe prej sëmundshmërisë, që shkaktohet për shkaqe të imitimit të mënyrave të huaja të jetesës dhe largimi nga stili tradicional i të jetuarit, duke qenë e sigurt se atëherë kur edukata familjare ka dobësi, pandemia do ta çojë më tej këtë dukuri.

Të dhënat nga Eurostat, INSTAT dhe institute statistikore të rajonit, të përpunuara nga revista “Monitor”, dëshmojnë se në vitin 2020 Shqipëria shënoi rritjen më lartë të vdekjeve në Evropë, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut, ku një pjesë e madhe e popullsisë është shqiptare. Sipas INSTAT-it, kapitali njerëzor i vendit tonë do të vijojë të ketë humbje të mëdha prej mangësive që po shkakton pandemia në arsim me mbylljen e shkollave dhe zhvillimin e mësimin pjesërisht ose të gjithin online. Harta e UNESCO-s tregon se në Shqipëri, shkollat janë mbyllur për rreth 24 javë, e barabartë me rreth dy të tretat e vitit shkollor, nga 22 javë në pjesë ta caktuara të botës, apo nga 14 javë

që shënon mesatarja kudo në botë, madje revista dinjitoze bën një parashikim të turbullt për të ardhmen, kur shkruan:

“COVID-19 e ka përkeqësuar krizën e të mësuarit dhe ndikimi në kapitalin njerëzor të këtij brezi nxënësish ka të ngjarë të jetë i gjatë.”

Duke pranuar rolin që luan te ky kapital i vyer materialja, gjykojmë dhe më fort besojmë se nuk duhet lënë mënjane roli themelor i edukatës të marrë familje, e cila e nisi rrugëtimin e vet në hershmërinë njerëzore si lidhje interesash biologjike të individëve, u ngjiz dhe u shenjtërua prej besimit, u legalizua në Kanunet e pashkruara, duke u bërë edukatë familjare plot aromë dhe lëng jete, larë me erz e njomur nga burimi jetëdhënës i mjedisit. Kësisoj lidhja e tillë për pjesëtarin e saj ishte aq e fortë, sa dikush që nuk i dëshmonte si moral qytetar tiparet e përfuara atje, përçmohej nga rrethi shoqëror me nëmën:

“Ti je xanë pa bismilah more mistrec (ndonji kalamanit të prapë, bastardh)”

(Dizdari, N. Tahir, 2005: 107)

BIBLIOGRAFI

- *Kurani i madhërishëm dhe kuptimet e Tij në gjuhën shqipe*, Mbështetur në përkthimin e prof. Hasan I. Nahit, Tiranë, 2017.
- Çabej, Eqrem, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Tiranë, 2006.
- Dizdari, N. Tahir, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
- Durant, Will & Durant, Ariel, *History and War, Theory Into Practice*, Apr., 1969, Vol. 8, No. 2, Teaching the Young to Love (Apr., 1969), pp. 56-57
Published by: Taylor & Francis, Ltd., 1969.
- Hoxha, Blerina, *Kriza e kapitalit njerëzor, si i përkeqësoi pandemia treguesit demografikë*, Monitor, Tiranë, 2021/4.
- Monitor, Prill, Tiranë, 2021.
- Murdock, George P. & Provost, Caterina, *Measurement of Cultural Complexity*, Ethnology, Vol. 12, No. 4 (Oct., 1973), pp. 379-392 (14 pages).
Published by: University of Pittsburgh-Of the Commonwealth System of Higher Education, 1973.

Hasan Bello¹⁵

Kriza e familjes shqiptare në vitet e regjimit komunist: Divorcet në vitet 60-të

Abstract

The establishment of the communist regime in November 1945 will be accompanied by radical changes not only in the socio-economic and political field, but also in the change of the family structure of the Albanian society. The efforts of the communist state for the emancipation of women, education, Marxist-Leninist ideological indoctrination and by engaging her in the process of industrialization of the country will be accompanied by the progressive increase of the number of divorces. This situation was the result of several objective factors. Thus, as soon as the Albanian Communist Party came to power, it set itself the goal of fighting "backward customs" and a series of traditions that had a positive impact on the preservation of family values of Albanian society. In the first place here came those traditions that had their source in religious beliefs such as Islam and Christianity, which played a positive role for the social stability of the family and society.

The moral erosion that society suffered from the indoctrinating policies of the communist regime was reflected in the shock the family received and the rapid increase in the number of divorces compared to the period before 1945. Therefore the study of this phenomenon by historians and sociologists is an area of interest and still unstudied to this day properly.

In this paper we will try to analyze and reflect on some key aspects of divorce, relying on the archival sources of the time.

Keywords: *Christianity, Islam, family, communist regime, divorce*

¹⁵ Instituti i Historisë, QSA

Sipas statistikave zyrtare, në vitet 1952-1953 kemi një rritje të ndjeshme të padive të shqyrtuara për zgjidhje martese nga gjykatat. Gjatë vitit 1954 kjo shifër pësoi një rënie relative. Kështu, nga 1521 padi të shqyrtuara 981 u pranuan duke përfunduar me divorc, 418 u refuzuan, 59 përfunduan me pajtim, 59 u pushuan dhe 4 u konsideruan jashtë kompetencës. Arsyeja e kësaj rënie nuk dihej me saktësi nëse ishte një fenomen i rastësishëm apo një tendencë që do të vazhdonte edhe përgjatë vitit 1955. Ekzistonte pikëpamja se shumë nga martesat e perealizuara siç duhej para vitit 1945, ishin zgjidhur për shkak të kushteve juridiko-sociale dhe frymës emancipuese që kishte krijuar regjimi komunist.

Numri i padive të shqyrtuara për zgjidhje martese nga gjykatat shqiptare në vitet 1952- 1954¹⁶

Viti	Nr. i padive të shqyrtuara për zgjidhje martese	Nr. i padive të refuzuara nga gjykata për zgjidhje martese	Nr. i padive të pranuar nga gjykata për zgjidhje martese
1952	2412	-	-
1953	1622	-	-
1954	1521	418	981

Përsa i përket shtrirjes gjeografike të divorcit në shkallë vendi, më tepër padi ishin regjistruar në qarkun e Korçës (238), pastaj vinte qarku i Vlorës (224), i Tiranës (210), Beratit (159), Gjirokastrës (147), Durrësit (135), Shkodrës

¹⁶ AQSH, F.MD, D.10, V.1954, fl.1., Relacion mbi paditë për zgjidhje martese nga gjykatat gjatë vitit 1954, Tiranë, 1954.

(135), Elbasanit (134), Peshkopisë (103), Kukësit (36). Numri i padive për divorc të ngritura nga burrat nuk kishin shumë ndryshim nga gratë. Në vitet 1951-1952-1953, 49% ishin ngritur nga burrat dhe 51% nga gratë. Në vitin 1954, 785 padi ose 52% ishin ngritur nga burrat dhe 736 padi ose 48% ishin ngritur nga gratë. Paditë e pranuara nga gratë dominonin me një përqindje të vogël krahasuar kjo me paditë e pranuara nga burrat. Kjo për shkak se gratë si rezultat i rrethanave tepër të vështira ekonomike dhe paragjytimeve që ekzistonin ishin më të matura kur kërkonin zgjidhjen e martesës. Një gjë e tillë reflektohej edhe në të dhënat për fajësinë që kishte shkaktuar tronditjen e lidhjes bashkëshortore. Kështu, nga martesat e zgjidhura në vitin 1954, 395 ose 40% ishin zgjidhur për fajin e burrit, 245 ose 25% për fajin e gruas, 213 ose 22% për fajin e të dyve, 128 ose 13% për fajin e asnjërit.

Por kur vinte puna për shkaqet e divorceve, dilte në pah kriza e familjes shqiptare në vitet e regjimit komunist. Gjithmonë kjo krahasuar me një apo dy dhjetëvjeçarë më parë. Kjo, sepse edhe vetë regjimi komunist kur vlerësonte arritjet në fusha të ndryshme të ekonomisë, arsimit apo shëndetësisë i krahasonte ato me vitet e regjimit zogist. Sipas të dhënave të hartuara nga Ministria e Drejtësisë, në vitin 1954, për 649 padi ose 66% ishte vendosur zgjidhja e martesës në bazë të nenit 86 të Kodit të familjes, për tronditje të marrëdhënies bashkëshortore; në 128 raste ose 13% për lënie ligësisht; në 127 raste për shkelje kurore; në 49 raste për dënim të njerit nga bashkëshortët nga gjykata; në 19 raste për keqtrajtim ose fyerje të rëndë; në 7 raste për sëmundje të pashërueshme; në 1 rast për absencë dhe në 1 rast për atentat kundër jetës.¹⁷

Për të frenuar këtë erozion që familja shqiptare po pësonte për shkak të ndryshimit të jetës social-ekonomike dhe politike, u propozua që kur të hartohej Kodi i ri i familjes si shkak i zgjidhjes së martesës të parashikohej

¹⁷ Po aty.

vetëm tronditja e marrëdhënieve bashkëshortore, i cili të përfshinte në vetvete edhe shkaqet e tjera. Kjo do të thoshte se autoritetet zyrtare nuk dëshironin evidentimin e shkaqeve specifike, që shumë bashkëshortë i çonte drejt zgjidhjes së martesës. A ishte kjo fshehje e të dhënave zyrtare me një emërtues të përbashkët për të gjitha shkaqet? Pse regjimi komunist i trembej artikulumit specifik të shkaqeve të divorcit? Sepse të dhënat, si tradhëtia bashkëshortore apo të tjera si këto binin ndesh me “moralin socialist”, me propagandën zyrtare të regjimit komunist dhe me revolucionin kulturor të PKS-së.

Përsa u përket martesave të zgjidhura, 845 burra dhe 862 gra e kishin martesën e parë, 118 burra dhe 104 gra martesën e dytë, 17 burra dhe 14 gra martesën e tretë. Ndërsa përsa i përket jetëgjatësisë së këtyre lidhjeve konstatohet se 103 martesat të zgjidhura ose 10 % kishin zgjatur vetëm 1 vit, 744 ose 76% vetëm 9 vite dhe 134 ose 14% mbi 9 vite. Ky është një argument që tregon se tendenca e rritjes së numrit të divorcit kishte ardhur duke u rritur në vitet e regjimit komunist. Pretendimi i autoriteteve zyrtare të kohës se shkaqet kishin ekzistuar para ardhjes së komunistëve në pushtet nuk është i vërtetë. Kjo sepse statistika e vitit 1954 e shpreh qartë se 76% e martesave kishin zgjatur vetëm 9 vite, duke konfirmuar faktin se ato ishin lidhje që ishin realizuar në vigjilje ose pas vendosjes së regjimit komunist.

Në krahasim me vitet e mëparshme Ministria e Drejtësisë konstatonte se ishte ulur numri i martesave të zgjidhura brenda një viti, por ishte shtuar ajo e martesave të zgjidhura brenda 9 viteve. Në lidhje me përkatësinë fetare të çifteve të divorcuara vihet re se tek myslimanët numri i tyre ishte 80 %, tek ortodoksët 17% dhe tek katolikët 3%. Këto përqindje reflektonin në përpjestim të drejtë strukturën religjioze të popullsisë shqiptare.¹⁸

Në emër të emancipimit kulturor dhe “moralin socialist” autoritetet zyrtare të kohës, në përputhje me Kodin e familjes, i shpallën luftë fenomenit të

¹⁸ Po aty, fl. 2.

poligamisë. Në fakt ky fenomen nuk ishte shumë i përhapur dhe kishte arsye të veta sociale të cilat buronin dhe nga tradita zakonore shqiptare. Kështu, nuk ishte e rralla rastet kur bashkëjetesa me një grua të dytë, e cila nga shteti konsiderohej ilegale, ishte realizuar me miratimin e bashkëshortes së parë. Shkaqe të tilla si steriliteti, moslindja e fëmijëve meshkuj apo bashkëjetesa me gruan e të vëllait të vdekur etj. ishin arsye thelbësore për ekzistencën e poligamisë kryesisht në zonat rurale dhe më pak në zonat urbane të Shqipërisë. Prandaj, parë nga ky këndvështrim poligamia nuk ishte krim familjar, por amortizim i problemeve sociale të kohës. Megjithatë lufta kundër saj u trumbetua me të madhe, duke ndikuar dashur padashur në shtimin e numrit të divorcit për shkaqe steriliteti, sëmundjesh të ndryshme apo të tjera si këto.¹⁹

Për të frenuar këto fenomene, nga organizatat e rinisë dhe gruas kërkohej që të bënin punë më të madhe sqaruese dhe edukuese me shtresat në fjalë për t'u ngjallur atyre frymën e urrejtjes kundër të ashtuquajturave zakone prapanike të së kaluarës. Të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Partisë dhe këshillave popullore të njihnin mirë dispozitat ligjore që dënonin këto zakone, t'i demaskonin ato para popullit dhe të denonconin pranë autoriteteve shtetërore të gjithë ata persona që vazhdonin të mbanin në jetë ato. Me masën e rinisë dhe të grave të zhvilloheshin leksione të veçanta lidhur me dëmin që sipas autoriteteve të kohës shkaktonte aplikimi i tyre.²⁰

Krizën e familjes shqiptare indirekt e pranonte dhe ministri i Drejtësisë dhe Drejtoria e organeve administrative që merrej me përpunimin e të dhënave lidhur me proceset gjyqësore të shqyrtuara nga organet e drejtësisë në rrethe. Sipas një relacioni të ministrit Bilbil Klosi, në vitin 1958 numri i divorceve kishte përsuar rënie të ndjeshme me 53.5% krahasuar me vitin 1952 kur paditë e shkurorëzimit dhe martesat e zgjidhura kishin arritur kulmin. Ky sukses i

¹⁹ Po aty, fl.4-5, Relacion mbi krimet kundër martesës dhe familjes të gjykuara në vitin 1954, Tiranë, 1954.

²⁰ Po aty.

pretenduar ishte arritur falë një pune të madhe që mekanizma të ndryshëm partiak dhe shtetëror kishin luajtur për konsolidimin e familjes shqiptare. Megjithatë të metat e konstatuara dhe puna që mbetej për t'u bërë ishte mjaft e madhe. Kjo pranohej dhe nga vetë ministri i Drejtësisë. Por në vend që ai t'ia hidhte fajin faktorëve objektivë që kishin ndikuar për shtimin e divorcit, theksonte se duhej intensifikuar veprimtaria për luftimin e zakoneve prapanike, mentalitetin e vjetër mbi martesën dhe familjen, nën influencën e të cilave lidheshin shumë çifte. Një numër i madh i këtyre martesave, duke mos patur një bazë të shëndoshë, sipas ministrit të Drejtësisë, përfundonin në divorc. Prandaj, numri i shkurorëzimeve akoma vazhdonte të mbetej tepër i madh.²¹ Në fakt ky konkluzion binte në kundërshtim me të gjitha teoritë sociologjike mbi divorcin dhe shkaqet e tij. Nga autorë të ndryshëm është konfirmuar se fenomene të tilla si industrializimi, arsimimi i gruas dhe sidomos goditja e elementëve konservatorë me karakter religjioz ose të traditës, përbëjnë shkaqe të drejtpërdrejta për rritjen e numrit të divorcit. Në Shqipëri nuk duhen harruar dhe faktorët ideologjikë për indoktrinimin e gruas me parimet e marksizëm-leninizmit. Këto faktorë binin ndesh me shoqërinë shqiptare, nivelin e zhvillimit ekonomik-shoqërorë, mentalitetin, traditën dhe zakonet e saj.

Në çiftet e divorcuara kishte dhe komunistë. Kështu, në vitin 1958 nga 1698 veta, 108 (6.3%) ishin anëtarë partie.²²

Martesat e lidhura dhe divorci në vitet 1946-1960²³

²¹ Po aty, fl.20, Relacion i ministrit të Drejtësisë Bilbil Klosi mbi punën e Partisë për luftimin e shkurorëzimeve dhe forcimin e familjes, Tiranë, 1958.

²² Po aty.

²³ Po aty, fl.7, Përgjithësimi i praktikës gjyqësore për paditë e shkurorëzimit të gjykuara në vitin 1958, Tiranë, 1958.

Viti	Martesa të lidhura	Martesa të zgjidhura	Në %
1946	11.207	713	6.4
1947	16.541	590	3.6
1948	17.712	1139	6.4
1949	11.580	1144	9.9
1950	12.341	976	7.9
1951	12.550	1114	8.8
1952	13.077	1515	11.6
1953	12.647	1447	11.4
1954	10.760	981	9.0
1955	11.258	1057	9.4
1956	10.368	957	9.2
1957	11.819	908	7.6
1958	11.931	849	7.1
1959	11.440	922	8.06
1960	12.565	850	6.8

Pasqyrë statistikore e përhapjes gjeografike të poligamisë²⁴

Nr	Rrethi	Personi (burra)	Me dy gra	Me tre gra
1	Peshkopi	127	126	1
2	Burrel	40	38	2
3	Elbasan	33	32	1
4	Kukës	77	77	-
5	Tiranë	81	81	-
6	Fier	34	34	-
7	Librazhd	62	61	1
8	Krujë	32	32	-

²⁴ Po aty, fl.24, Shtesë e relacionit mbi punën e Partisë për luftimin e shkurorëzimeve dhe forcimin e familjes, Tiranë, 1958.

9	Vlorë	20	20	-
10	Shkodër	16	16	-
11	Durrës	13	13	-
12	Tropojë	12	12	-
13	Tepelenë	11	11	-
14	Gjirokastrë	5	5	-
15	Përmet	3	3	-
16	Lushnje	7	7	-
17	Skraparë	3	3	-
18	Korçë	7	7	-
19	Lezhë	3	3	-

Ky fenomen mbeti shqetësues për shtetin shqiptar dhe për organet e drejtësisë edhe në fund të viteve 60-të dhe në fillim të viteve 70-të. Ai vazhdoi të kamuflohej me arsye të ndryshme siç ishte mentaliteti i kohës dhe zakonet prapanike. Autoritetet zyrtare në çdo raport të hartuar për instancat e interesuara i mëshonin faktit se numri i divorceve kishte ardhur duke u ulur si rezultat i punës që mekanizmat partiakë kishin zhvilluar për forcimin dhe konsolidimin e familjes shqiptare.²⁵ Por asnjëherë nuk u evidentuan shkaqet e vërteta të krizës që po kalonte institucioni i familjes. Asnjëherë nuk u fol për shkaqet ekonomike, juridike, politike etj., siç ishte bie fjala biografia e keqe, internimet, burgosjet, imoraliteti dhe tradhëtia bashkëshortore.

Pas vendosjes së regjimit komunist propaganda antifetare do të intensifikohet duke e arritur kulmin në vitin 1967 me ndalimin me ligj të besimeve fetare. Kjo ishte një faktor që ndikoi akoma më shumë në krizën morale dhe familjare të shoqërisë shqiptare, duke e rritur ndjeshëm numrin e divorceve.

²⁵ AQSH, F.MD, D.24, V.1961, fl.1-5, Përgjithësim i praktikës gjyqësore mbi paditë për zgjidhje martesë nga gjykatat gjatë vitit 1961, Tiranë, 12 korrik 1961.

Bibliografi

AQSH, F.MD, D.10, V.1954, fl. 1., Relacion mbi paditë për zgjidhje martesë nga gjykatat gjatë vitit 1954, Tiranë, 1954.

Po aty, fl.4-5, Relacion mbi krimet kundër martesës dhe familjes të gjykuara në vitin 1954, Tiranë, 1954.

Po aty, fl.20, Relacion i ministrit të Drejtësisë Bilbil Klosi mbi punën e Partisë për luftimin e shkurorëzimeve dhe forcimin e familjes, Tiranë, 1958.

Po aty.

Po aty, fl.7, Përgjithësimi i praktikës gjyqësore për paditë e shkurorëzimit të gjykuara në vitin 1958, Tiranë, 1958.

Po aty, fl.24, Shtesë e relacionit mbi punën e Partisë për luftimin e shkurorëzimeve dhe forcimin e familjes, Tiranë, 1958.

Kristaq Balli ²⁶

Imazhi ikonografik midis artit pagan dhe atij bizantin

Abstract

Early Christian art is the manifestation of a new spirit, as well as the result of an evolution, which took place through the regional cultures of the ancient world that it met on its historical path: in Palestine it met Judaism, in Greece and the Near East encountered Hellenism and oriental variants, while in Italy he met the Roman spirit with his concept of image. Judaism has generally held a privative or negative attitude towards the image. Jewish synagogues and tombs exhibit this early limitation. Figurative images were excluded; only ornaments were used. Their images originated in the older oriental cults. Some statues, such as those of Athena and Artemis of Ephesus, were said to be "not man-made" and had fallen from heaven. Hellenic pagan art, consciously or not, had an influence on Christian and iconographic art. Favored by its position between East and West, as well as by the political and economic power of the new Christian empire, Constantinople became the center around which a new art crystallized. Byzantium fulfilled itself with a new spiritual content, which expressed the essence of Eastern Christianity." After a slow period of four centuries, the image was generally accepted throughout the church. However, in the 8th and 9th centuries, because of the maturation of numerous religious and different political and economic tendencies, the iconoclastic phenomenon (the destruction of icons) was twice generated. In 843²⁷, Theodora the widow of emperor Theofilos (d. 842) and the regent to her small son, Michael III,

²⁶ Conservation Engineer, art scholar.

Email: kristaqballi@yahoo.com

convened a synod, at which the legitimacy of the veneration of images was finally proclaimed. March 11, 843 celebrated the great event of Orthodox victory. This event has been declared as the Feast of Orthodoxy. Undoubtedly, the triumph over the iconoclastic movement influenced very positively on the field of Byzantine art, which would convey to our day the splendor of one of the most valuable assets of civilization and human intellect. But, on the other hand, the iconoclasm became the beginning of a split of the Roman Empire between West and East, which would deepen and influence the final division (schism) of the Eastern and Western church.

Key words: *pagan art, catacombs, byzantine art, iconoclasy, schism, orthodoxy*




Fig. 1

Arti i hershëm kristian është manifestim i një shpirti të ri si dhe rezultat i një evoluimi, i cili u zhvillua nëpërmjet kulturave rajonale të botës antike, të cilat i takoi. Krishtërimi i takoi këto kultura në rrugën e tij

historike dhe nga përfshirja e disa prej elementeve të tyre, ai gërshetoi e plotësoi drejtimin e tij në rrugën e vetrealizimit: në Palestinë ai takoi Judaizmin, në Greqi dhe vendet e Lindjes së Afërt u ndesh me helenizmin dhe me variantet e tij orientale kurse në Itali takoi shpirtin romak me konceptin e tij për imazhin.

Judaizmi përgjithësisht ka mbajtur një qëndrim mohues apo negativ ndaj imazhit. Ky qëndrim bazohej në ndalimin me ligj (që i kishte bërë Torah: “Ju nuk mund ta bëni veten një imazh të gdhendur ose në ngjashmëri me ndonjë send në qiell, mbi ose në tokë, në ose nën ujë.” Paraqitja figurativisht e perëndive konsiderohej idhulltari (idolatri). Refuzimi sistematik i imazheve është vendosur në kohën kur judaizmi e ndjeu veten të kërcënuar nga helenizmi dhe, sipas gjasave, synonte mbrojtjen e popullit të Izraelit nga rreziku i idolatrisë. Sinagogat hebraike dhe varret e shfaqin këtë kufizim të hershëm. Imazhet figurative përjashtoheshin; përdorshin vetëm ornamente. Ky qëndrim kishte gjithashtu nota politike, të cilat synonin ta mbronin kulturën kombëtare ndaj romakëve. Autoritetet hoqën, kështu, nga tempulli në Jerusalem emrin e Perandorit, gjithashtu ranë dakord që procesionet të shkonin rreth dhe jo përmes qytetit, për deri sa legjionet e tyre mbanin imazhin e perandorit në flamujt e tyre. Ky tregues ka influencuar edhe në fenë islame.

Megjithatë bota hebraike, në disa raste, ka treguar edhe tolerancë ndaj imazheve. Zbulimet arkeologjike e pasqyrojnë këtë; në mënyrë të veçantë hebretë e diasporës ndiheshin shumë më favorizues ndaj imazhit. Shembullimi më domethënës i këtij arti imazhesh është sinagoga e Dura-Europos në Mesopotami (Shek. III, Fig. 1) në artin figurativ të së cilës shohim tregimet e profetëve Moisi, Elijah, Daniel dhe të tjerë personazhe biblike. Disa mendojnë se ky art është pararendësi i artit bizantin.

Për grekët paganë imazhi kishte një karakter mistik, madje magjik. Imazhet e tyre e kishin origjinën në kultet më të vjetra orientale. Disa statuja si ato të Athinasë dhe Artemisit të Efesit



thuhej se ishin “jo të bëra me dorën e njeriut” dhe se kishin rënë nga qielli. Njerëzit i nderonin ato nëpërmjet riteve të pastrimit e vajosjes, i zbukuronin me lule, madje ju servirnin dhe ushqime. Por filozofë të tillë si Ksenofani i Kollofonit (shek. VI-V, para Krishtit), Edhe Platoni më herët (428-347, para Krishtit) e kishte konsideruar këtë një lloj veneracioni popullor. Sidoqoftë, arti pagan helen, në mënyrë të vetëdijshme, ose jo, pati influencë në artin kristian e ikonografik. Kështu, p.sh., koka e Meduzës¹⁾ u mor si një prej modeleve të mundshme për ikonën. (Fig. 2) Çdo kthim në artin e vjetër le një shenjë në qytetërimin që e inspiroi artin kristian; ky inspirim u përpoq të transpozohet në një mënyrë kristiane²⁾.




Në

Perandorinë Romake imazhet luanin një rol të veçantë. Historikisht, në fillim, feja romake nuk kishte imazhe. Arti ishte i influencuar nga ai helen dhe kishte në bazë kryesisht

adhurimin e perëndive romake. Bota romake e aplikoi këtë lloj imazhi jo vetëm në fushën fetare, por ai plotësonte, gjithashtu, edhe një funksion juridik. Në rrethana të caktuara imazhi i perandorit, p.sh. zinte vendin e vetë prezencës së Perandorit. Kështu, një qytet i jepte çelësin e tij Perandorit si shenjë bindjeje ndaj tij, por, në qoftë se ai nuk ishte aty i pranishëm, çelësi i jepej një personi tjetër, veçse në prezencën e imazhit të Perandorit. Bindja konsiderohej, kështu, legale. Kjo traditë perandorake romake iu bashkëngjiti traditës së kultit religjioz dhe, padyshim, ndikoi në imazhet kristiane. (Fig. 3) Mandej, është konfirmuar³⁾ se të krishterët asimiluan shembëlltyrat pagane të kohës së dukej të ishte nën influencën e ceremonisë së oborrit: Perandori ose Perandorja në fron u bë Krishti, ose Virgjëresha midis engjëjve apo shenjtorëve; oferta e dhuratave u bë adhurimi i magëve të ditur; hyrja triumfale e perandorit u bë hyrja e Krishtit në Jerusalem. Shembullimet pagane shërbyen, kështu, si matrica për shembullimet e krishtera.

Të krishterët e parë palestinezë, të gjetur në një mjedis me imazhe, i konsideruan ato forma idolatrike apo shfaqje të paganizmit. Për kishën primitive arti i imazhit human nuk kishte rëndësi dhe nuk përfillej. Po ashtu, të përbërë nga komunitete të vogla besimtarësh të varfër, kisha nuk kishte nevojë për ndërtesa të mëdha. Zotëruesit e tyre të krishterë nuk kishin mundësi të porositnin vepra arti nga artistë, të cilët paguheshin mirë nga mecenatët e tyre paganë. Madje, nqs këta artistë donin të ktheheshin në të krishterë, duhet të ndërronin profesionin e tyre. Imazhi pagan në vetvete funksionoi dhe teoria e tij ishte shumë divergjente me shpirtin e kristianizmit për imazhe të tilla që të

bëheshin mjete shprehjeje e besimit kristian, të paktën pa disa ndryshime radikale.⁴⁾ Me këto ndryshime të thella u shfaq edhe aty arti i katakombeve⁵⁾, i cili u konsiderua si më i



përshtatshmi në qendra të ndryshme liturgjike kristiane, ku “kishat” e asaj periudhe ishin dhoma të vogla në shtëpi private dhe në katakombe. (Fig. 4)



Fig. 5

Fillimisht të krishterët përshtatën simbolet e pastra pagane, por u dhanë atyre një domethënie më të thellë. Simbolet me origjinë pagane ishin jo vetëm dekorime të thjeshta, por ato pasqyronin mësimet rreth të vërtetës së besimit kristian; ato e udhëhiqnin besimtarin drejt një kuptimi më të thellë të ungjillit pa ekspozimin e mistereve të tij tek të huajt. Kështu bariu i mirë (fig 5) paraqitej si Hermesi-simbol i “njerëzores”. Paraqitja e Moisiut duke nxjerrë ujë nga shkëmbi e ka origjinën në një skenë të Mithridates. Oranti, një person me krahët e ngritur në lutje u bë simbol i “devocionit” romak. Një kategori tjetër simbolesh të përdorura nga krishterët e hershëm e merrnin frymëzimin nga “Dhiata e vjetër”. (Adami dhe Eva, Danieli në strofullën e luanëve, Tre djemtë në furrë, etj.) Madje këto simbole ishin më të rëndësishme




Fig. 6

se ato të “Dhiata e re”.



Fig. 7

Kristianët e hershëm përdornin simbolet e kohës së tyre dhe, kur ata kishin nevojë për simbole të reja, i krijonin me thjeshtësi ato. Kështu nga shek. II filluan të shfaqen simbolet e një frymëzimi tipik kristian, shtimi i

bukëve si paraqitje e gostisë eukaristike, adhurimi i burrit të ditur si një simbol i bindjes pagane tek besimi kristian, etj. Mbi të gjitha simbolet sekrete, të cilat, megjithëse të pakuptueshme nga paganët, iu përshtatën mirë principeve të



fshehtësisë të imponuara nga të krishterët: hardhia si misteri i jetës së Zotit tek të krishterët e pagëzuar (Fig. 6) dhe, më i rëndësishmi, simboli i peshkut. Për hebrenjtë peshku kishte qenë një simbol i ushqimit mesianik dhe u bë simboli i Krishtit. Çdo shkronjë e fjalës biblike greke *i/h/th/i/s* për peshkun (që nënkupton peshkun) i referohej Krishtit ΙΧΘΙΣ: Jesu/Krisht/i

Zotit/bir/shpëtimtar. Që nga shekulli II simboli u përdor gjerësisht, në e gjejmë atë në sarkofagë, në muret e katakombeve, si dhe në objekte të vegjël. Simboli i peshkut i ndihet të krishterët edhe për të njohur njeri-tjetrin.

Një tjetër simbol që përdorën të krishterët e hershëm ishte pëllumbi. (Fig. 8) Në tregimin e pagëzimit të Krishtit dhe në të tjera skena ungjillore, Fryma e shenjtë vjen nga qiejt si një pëllumb. Një kuptim tjetër sekret i pëllumbit gjendet në “Testamentin e vjetër”, në tregimin mbi Noen dhe Përmbytjen e Madhe, ku ishte një pëllumb që u kthye tek Noe me një degëz ulliri në sqep, për të bërë të ditur se përmbytja e madhe kishte mbaruar. Pëllumbi ishte dhe njëhej, gjithashtu si një simbol i paqes.

Pikturat e katakombeve shfaqin një unitet të habitshëm të stilit të subjekteve. Simbole të njëjta gjenden kudo, nga Azia e Vogël në Spanjë, nga Afrika veriore në Itali. Kjo, nga ana tjetër, ishte tregues që kisha akoma nuk kishte vendosur ndonjë program artistik zyrtar⁶⁾.

Duke veçuar përjashtime të vogla, pikturat paraqitnin karakteristika të njëjta deri në kohën e Kostandinit (shek. III-IV): në ekzekutimin e tyre imazhet manifestonin një thjeshtësi të madhe kuptimesh, përpjekje të vogla për diapazon të gjerë ngjyrash. Ky kërkim i vetëdijshëm për botën shpirtërore ishte i ndarë shumë qartë nga estetika natyraliste e kohës.



Imazhi i shenjtë kristian nuk mund të shkonte përtej këtij kufiri, sepse kisha akoma nuk kishte përcaktuar dimensionet e misterit të mishërimit, gjë që do të bëhej në kohën e sinodheve të parë. Sidoqoftë, simbolet që mësonin mbi Krishtin u dhanë njerëzve një ndjenjë sigurie. Ata ndjenin se sundimtarët e egër nuk mund të zbulonin çka ata bënin. Me anë të këtyre simboleve, të krishterët njihnin njëri-tjetrin. Ata që nuk dinin shkrim e këndim, duke parë simbolet, kuptonin përmbajtjen e tyre, madje, njerëzit që flisnin gjuhë të ndryshme dinin njëllor kuptimin e simboleve.⁷⁾

Me mbërritjen e Kostandinit (~274-337) dhe të Paqes së Kishës⁸⁾, konvertimit të perandorëve dhe dyndjes së kristianëve të rinj, vihet re fillimi i një vizioni estetik, i cili do të formonte artin e shekujve të pastajmë. Në Romë, ashtu si edhe në Kostandinopol, arti mori një përmbajtje të re, të ndryshme, pasi fuqia e “bazileut” kristian u ekzaltua: ky art u bë një pasqyrim i plotfuqishmërisë hyjnore. Meqë konvertimet u shtuan në klasat më të larta, nevojat e reja estetike u bënë më të ndjeshme: si rezultat u ndërtuan ndërtesa të mëdha nën patronazhin e kësaj aristokracie të re kristiane, duke bërë të nevojshme, kështu, edhe adoptimin e vizionit estetik kristian. Në gjithë

perandorinë, shumica e artistëve punuan vetëm për lavdinë e besimit të ri. Shfaqet, kështu, krijimi i një programi të ri të tipave dhe imazheve. Megjithëse Krishti, më parë, paraqitej si një filozof me mjekër, tani ai u bë i ri, i rrojtur dhe me tipare të buta. Krishti nuk ishte më një doktor, por një mjeshtër i ulur në thronin⁹⁾ e tij; apostujt dhe



Fig. 10

shenjtorët mblidheshin rreth tij të gatshëm të merrnin ligjin në duart e tyre të mbuluar në mënyrën e ceremonisë së oborrit perandorak. (Fig. 9)

Krijimi i Perandorisë Romake të Lindjes, Bizantit (V. 330) pati një ndikim pozitiv deontologjik në artin e ri të krishterë.

Në qoftë se në fillim të shek. IV arti kristian përshtati format e artit perandorak, nga fundi i këtij shekulli lëvizja ndryshoi. I favorizuar nga pozicioni i tij midis Lindjes dhe Perëndimit si dhe nga fuqia politike dhe ekonomike e perandorisë së re kristiane, Kostandinopoli u bë qendra rreth të cilit u kristalizua ky art i ri. I krishterë në esencën e tij dhe helenik e oriental në rrënjët e tij, ky art mori emrin “bizantin”. Në kryeqytetin Konstantinopojë influencat e botës antike erdhën së bashku për të formuar një gjuhë artistike të një përbërjeje dhe homogjeniteti të rrallë.

Për të kuptuar karakterin specifik të imazheve të shenjta në Bizant, që është në thelb ai i ikonës, duhet të kujtojmë një element historik, cili është i lidhur ngushtë me konvertimin e perandorit Kostandin (274-337): para betejës në Milvian Bridge (Ura Milvian) mbi lumin Tiber, Kostandini pa në qiell një kryq flakëruar me këto fjalë shoqëruese: “Me këtë shenjë fiton.” (In hoc signo

Vinces). Gjatë natës Krishti iu shfaq atij duke mbajtur në dorën e vet të njëjtin imazh, që Kostandini kish parë në qiell. Krishti e porositi atë ta vendoste këtë imazh në një shqytë dhe ai do ta paraprinte ushtrinë e tij në betejë. (Fig. 10)

Ishte Perandori Kostandin që transferoi kryeqytetin perandorak nga Roma në Kostandinopojë si dhe ai që lëshoi dekretin me të cilin zyrtarizoi besimin e krishterë.

Gjatë një procesi që do të zgjaste dy-tre shekuj (deri tek Justiniani, 483 - 565), imazhi hyjnor do të gjente formën e tij përfundimtare. Nga bota helenistike, arti hyjnor kristian mori harmoninë, masën, ritmin dhe elegancën dhe refuzoi format idealistike. Nga Lindja, Jerusalemi dhe Antiokia, imazhi mori tiparet realiste, portretin por pa adoptuar natyralizmin e rëndë, të shoqëruar me artin oriental. Arti bizantin përpunoi gradualisht stilin e vet të veçantë duke përzier në shkallë të caktuar sensualizmin antik dhe tendecat ekspresioniste primitive të Lindjes, duke ruajtur në themel antropomorfizmin helenistik.

Bizanti e plotësoi veten me një përmbajtje të re shpirtërore, e cila shpreh thelbin e krishtëritimit lindor¹⁰⁾ Që nga kjo kohë, Krishti do të shfaqej me flokë të gjatë, mjekër dhe sy të errët. Velloja e veshur nga gratë, e cila mbulonte flokët e tyre dhe binte deri nën gjunjë (si tek ikonat e Virgjëreshës) e kishte origjinën nga qytetërimi lindor. Influenca orientale ishte, ndofta, më e madhe në arkitekturën dhe skulpturën bizantine, ku ai lindi shumë forma të reja. Nga integrimi i kaq shumë elementëve të ndryshëm, arti i krishterë u bë një instrument perfekt për shprehjen e plotësisë së besimit: ai unifikoi dhe shenjtëroi së bashku diversitetin e kulturave¹¹⁾. Kështu, në këta shekuj, arti hyjnor krijoi një pasuri temash dhe formash dhe zuri vendin e vet në jetën e kishës. Deri në këtë kohë arti bizantin nuk ndryshonte esencialisht nga arti hyjnor në Perëndim. Lindja dhe Perëndimi së bashku formuan komunuelthin (federatën) kristian.

Periudha e parë e veprimtarisë krijuese të artit kristian, siç tregohet në ikona, nuk synonte të shprehte thelbin e saj. Në qoftë se duam të shprehim këtë thelb në pasurinë e tij specifike, duhet të marrim në konsideratë teologjinë. Kjo teologji na lejon të vendosim kultin e ikonës në perspektivën e saj të vërtetë: as hyjnishmërinë e artit, as supersticionin magjik, por tek një kult simbolik, i cili i ka rrënjët e tij në misterin e mishërimit (personifikimit) të Krishtit¹²⁾ Kuptimi i një simboli domethënës shfaqet, gjithashtu, në devocionin popullor. Shekujt IV dhe V ishin jo vetëm epoka e artë e etërve të Kishës dhe monasticizmit, por edhe epoka kur njerëzit dëshironin të nderonin shenjtoret dhe vendet ku ata u martirizuan. Pas një periudhe të ngadaltë prej katër shekujsh, imazhi u pranua përgjithësisht në të gjithë kishën. Ai luante një rol në besimin e njerëzve dhe, duke qenë i transformuar në një portret kultik, imazhi u bë ikonë.¹³⁾


Megjithatë, në periudha të caktuara, u manifestua edhe një kundërshtim i imazheve, por deri në shek. VIII këto protesta ishin të kufizuara dhe nuk patën ndonjë pasojë për kishën.

Duhet dëshmuar se rëndësia që etërit i atribuon imazhit nuk ishte e natyrës artistike, por e asaj pastorale. Kështu në Elogynë e tij, Shën Grigori i Nisës u shpreh kështu për martirin Theodor: “Artisti duhet ta tregojë gjithë këtë nëpërmjet artit të ngjyrave si në një libër që ka një gjuhë me të cilën të flasë. Imazhi mund të flasë nga muret, ku ai duket nga të gjithë dhe luan rolin e shërbimit më të madh.”¹⁴⁾

Në ditët tona ka mbërritur një tekst nga peshkopi i Neapolit të Qipros, Leontius, i cili shpjegon qartë arsyet e imazhit: “Unë paraqit Krishtin në kisha, shtëpi, në vende publike, në kanavace, në qilare, në rroba, kudo, kështu që, kur i shohim ato, ne mund të kujtojmë... Për ne të krishterët nga pasja e imazheve të Krishtit, është Krishti dhe martirët e tij që ne puthim në zemrat tona... Si rezultat, ai që respekton Zotin me nderim, nderon Birin e Zotit, Krishtin, Zotin tonë dhe përfaqësuesit e kryqit të tij dhe imazhet e shenjtoreve të tij.” Andaj

ikona konsiderohet si vepër arti që shkon përtej artit. Larg të qenit i kufizuar vetëm tek niveli estetik, mesazhi i ikonës është së pari i një karakteri teologjik. Kjo është arsyeja pse ikona ka folur njëlloj me njeriun e të gjitha kohrave. Ajo është proklamimi i parë e kryesor i vlerave të përmbajtjes. Problemi i saj kryesor ishte të transformonte format tokësore, pra të bënte botën qiellore të dukshme.

Në prag të polemikave ikonoklastike, në vitin 692, Perandori Justinian II thirri një sinod ekumenik i njohur në Kostandinopol, i njohur si Sinodhit Quinisext, i cili pati rëndësi të veçantë për ikonografinë kristiane.¹⁵⁾ Midis 102 kanuneve që përfshinin të gjitha aspektet e jetës së kishës, 3 prej tyre i takonin



direkt ikonografisë. Kanuni 73,

p.sh. ritheksoi rëndësinë e kryqit të shenjtë dhe nderimin e tij. Kanuni 100 ndalonte “pikturat mashtruese”, të cilat i ekspozoheshin publikut, që degjeneronin inteligjencën nga eksitimi i kënaqësive të turpshme...” Kanuni më i rëndësishëm, sidoqoftë, ishte ai 82¹⁶⁾, i cili shprehte për herë të parë mësimin e Kishës për ikonat dhe shënonte njëherësh mundësinë e përcuarjes të një pasqyrimi të lavdisë hyjnore nëpërmjet kuptimit të artit...¹⁷⁾ Por Sinodit Quinisext që merrte në mbrojtje ikonat, i duhej thujse një shekull që të pranohej.

Gjatë kësaj kohe, si rezultat i pjekjes së tendencave të shumta fetare, politike e ekonomike, u gjenerua fenomeni ikonoklastik. Komplexiteti i tij si fenomen nuk e bën të

qartë saktësisht origjinën e tij, apo edhe faktorët që stimuluan evoluimin e tij, por çështjet dogmatike, sigurisht, përbëjnë sfondin kryesor të problemit. Por në konfliktin ikonoklastik influencuan edhe disa praktika supersticioze idolatrike¹⁸⁾, që motivuan opozitën ikonoklaste. Gjithashtu, aspekte të caktuara të politikës agrare të perandorit ndaj pakësimit të pronave tokësore të manastireve, apo rivaliteti ndërmjet artit laik dhe atij fetar, influencuan në lëvizje të gjera pro ikonoklaste.

Në vitin 721 Kalifi Yazid II ndërmori masa ekstreme për të eliminuar të gjitha imazhet nga faltoret dhe shtëpitë e provincave nën autoritetin e tij.

Aty nga viti 725 lëvizja ikonoklaste u mbështet nga tri peshkopë nga Azia e Vogël: Teodosi i Efesit, Tomas Klaudiopolis dhe Kostandin Nacolias. Me ndihmën e Perandorit Leo III ata vijonin shkatërrimin e imazheve në rajonet e tyre. Madje një shpërthim i fuqishëm vullkanik nënujor i asaj kohe pranë Santorinit në veri të Kretës, u interpretua nga Leo III si ndëshkim e fatkeqësi ndaj nderimit idolatrik të imazheve, me çrast ai shkatërroi edhe ikonën e madhe të Krishtit mbi portën hyrëse të Kostandinopolit. (Fig. 11, 12). Imazhet e kishave u zëvendësuan me lule, ornamente, zogj dhe, madje, skena nga gjuetia e garat me kuaj. Pra piktura iu kthye modeleve antike, atyre pagane, dukuri që e shprehu veten edhe në liturgji. Një persekutim sistematik filloi në Kostandinopol. Çdo qytetar duhej të sillte ikonat e tij në një shesh publik, ku ato digjeshin. Shumë klerikë, murgj dhe besimtarë, që kundërshtuan, u dënuan, torturuan, ose u vranë, të tjerë ikën nga kryeqyteti.

Por jashtë kufijve të perandorisë, kundërshtarë të frikshëm filluan luftën kundër Perandorit. Papa i ri, Grigori III, iu përgjigj letrave të Leos me

një energji apostolike. Më 731 Papa thirri një Këshill Ekumenik në Romë, i cili shkishëronte çdo njeri që “kundërshtonte nderimin e imazheve të shenjta dhe blasfemonte, shkatërronte, apo përdhoste ato.”¹⁹⁾

Perandori Leo III u irritua nga kjo rezistencë, sa i konfiskoi pasuritë e Shën Pjetrit, rriti taksat në Kalabri e Siqeli dhe, përfundimisht, shkëputi provincat e Ilirisë nga juridiksioni romak për t’ia shtuar ato patriarkatit të Kostandinopolit.

